



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT  
TË PËRGJITHSHËM DIBËR

**UDHËZIM I PËRGJITHSHËM**

Nr.40, datë 28.03.2024

**PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE NDËRMJET PROKURORËVE DHE  
DREJTUESIT TË PROKURORISË, INFORMIMIN, TRANSPARENCËN DHE  
GARANTIMIN E PAVARËSISË, NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË  
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR**

Unë **Abaz MUÇA**, Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në mbështetje të neneve 42 dhe 46 të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 4 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”<sup>1</sup>, udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar me udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.16, datë 14.12.2020 “Për disa ndryshime në udhëzimin e përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm””,

**U D H Ë Z O J:**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është lehtësimi i zbatimit të udhëzimit përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet

<sup>1</sup> Miratuar me urdhërin nr.37, datë 25.03.2024, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar me udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.16, datë 14.12.2020 “Për disa ndryshime në udhëzimin e përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm””.

2. Ky udhëzim ka për qëllim për të unifikuar të drejtat dhe detyrimet të prokurorit e ushtrimit e funksioneve, marrëdhëniet e tij me Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër si prokurori më i lartë dhe informimin e koordinimin në veprimtarinë e prokurorësi, për të siguruar pavarësinë dhe autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, mbikëqyrjen, eficientë, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorisë si organ kushtetues e pavarur.

3. Nëpërmjet këtij udhëzimit synohet qartësimi i kuptimit dhe zbatimit në praktikë të disa çështjeve ligjore që lidhen me respektimin e parimeve të ligjshmërisë<sup>2</sup>, detyrueshmërisë së ndjekjes penale<sup>3</sup> dhe pavarësisë<sup>4</sup> në marrëdhëniet ndërmjet prokurorit me Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në përjasje me standardet dhe praktikat e mira evropiane për unifikimin dhe përmirësimin e veprimtarisë organizative dhe funksionale apo procedurale në prokurori.

## Neni 2 Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:

a) Garantimi i pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit në ushtrimin e funksioneve procedurale në kryerjen e hetimeve, përfaqësimin e akuzës dhe/ose çështjes në gjyq dhe urdhërimin ose mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale në raport me detyrueshmërinë e ndjekjes penale dhe zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e prokurorisë.

b) Përcaktimi i raporteve apo marrëdhënieve administrative dhe funksionale ose procedurale penale, ndërmjet prokurorit me zëvendësdrejtuesin dhe Drejtuesin e Prokurorisë pranë

---

<sup>2</sup> Shih nenin 4 të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon:

“1. Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi.

2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik.”.

<sup>3</sup> Shih nenin 5 “Detyrueshmëria e ndjekjes penale” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “Ushtrimi i ndjekjes penale është i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.”.

<sup>4</sup> Shih nenin 6 “Pavarësia e prokurorëve” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon:

“1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashitje, kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

2. Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat.”.



Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë saj.

c) Mënyrat e informimit në të gjitha hallkat dhe nivelet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale, ndalimin e publikimit të akteve dhe ruajtjen e sekretit të hetimeve.

## **KREU II GARANTIMI I PAVARËSISË SË PROKURORIT**

### Neni 3

#### **Pavarësia e prokurorit, detyrueshmëria e ndjekjes penale dhe respektimi i ligjshmërisë të veprimtarisë në prokurori**

1. Prokurori ka pavarësi dhe autonomi në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore për kryerjen e veprimeve procedurale, parashtrimin e kërkesave dhe marrjen e vendimeve në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm, i çdo autoriteti publik apo privat, gjatë hetimeve paraprake, përfaqësimit të akuzës dhe/ose çështjes në gjykatë dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale apo mbikëqyrjes të zbatimit tyre<sup>5</sup>.

2. Në ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur, prokurori duhet të bazohet në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë, duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtur liritë e të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve, interesin e shtetit dhe atë publik në procesin penal.

3. Pavarësia procedurale nuk e shmang prokurorin nga detyrimi për të përmbushur funksionet dhe/ose përgjegjësitë kushtetuese e ligjore që ka, për të ushtruar ndjekje penale për çështjen që i ngarkohet dhe në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë udhëzimet e përgjithshme të nxjerra nga prokurori më i lartë, me qëllim unifikimin e qëndrimeve në veprimtarinë e prokurorisë për çështje të caktuara, përfshirë dhe zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave apo rezolutave të Kuvendit për luftën kundër kriminalitetit.

### Neni 4

#### **Ankimi kundër udhëzimit të përgjithshëm**

1. Prokurorët më të lartë mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme të arsyetuara me shkrim të natyrës administrative ose procedurale të cilat janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët<sup>6</sup>.

<sup>5</sup> Shih nenin 25 pika 2 “Ushtrimi i funksioneve të prokurorit” të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon: “2. Në ushtrimin e funksioneve të tij prokurori është i pavarur. Rregullat për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga prokurori parashikohen në ligj.” dhe nenin 6 pika 1 “Pavarësia e prokurorëve” e vijues të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashirojnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.”

<sup>6</sup> Shih nenin 46, pikat 1, 2 dhe 4 “Udhëzimet e përgjithshme të detyrueshme” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon:

“1. Prokurorët më të lartë mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme dhe të arsyetuara me shkrim, të cilat janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët.

2. Udhëzimet e përgjithshme, sipas këtij neni, mund të jenë të natyrës administrative ose procedurale.



2. Prokurori, në rastet kur vlerëson se udhëzimi i përgjithshëm është i pabazuar në ligj, apo është haptazi në kundërshtim me ligjin, mund të bëjë ankim kundër udhëzimit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë<sup>7</sup>, duke ndjekur procedurën si më poshtë:

a) Ankimi i prokurorit kundër udhëzimit të përgjithshëm duhet të paraqitet në Këshillin e Lartë të Prokurorisë brenda 30 ditëve<sup>8</sup> nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen e udhëzimit.

3. Prokurori është i detyruar të zbatojë udhëzimin e përgjithshëm të ankimuar nga ana e tij<sup>9</sup>, me përjashtim të rasteve, kur prokurori vlerëson se udhëzimi është haptazi në kundërshtim me ligjin.

4. Prokurori më i lartë, kërkon fillimin e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe/ose hetimin disiplinor ndaj prokurorit<sup>10</sup> në rastet kur ai nuk zbaton udhëzimet e përgjithshme dhe vepron haptazi në kundërshtim me ligjin apo vepron me keqdashje apo pakujdesi të rëndë në veprimtarinë procedurale të tij.

5. Prokurori, kërkon fillimin e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme në rastet kur Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër apo zëvendësdrejtuesi i saj nuk zbaton udhëzimet e përgjithshme dhe vepron haptazi në kundërshtim me ligjin apo vepron me keqdashje apo pakujdesi të rëndë në veprimtarinë procedurale të tij.

## Neni 5

### **Qëndrimi i prokurorit ndaj ndërhyrjes ose ushtrimit të ndikimit të paligjshëm**

1. Prokurori në çdo rast që evidenton ndërhyrje ose ushtrim ndikimi, të papërshtatshëm, apo në kundërshtim me ligjin ndaj tij, nga brenda sistemit të prokurorisë, apo nga përfaqësues të pushtetit legjislativ, ekzekutiv, medias apo çdo personi tjetër juridik a fizik apo subjekt i procedimit penal, menjëherë refuzon çdo ndërhyrje ose ushtrim ndikimi të paligjshëm<sup>11</sup>, merr

*4. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që drejtojnë, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas nenit 43, shkronja "dh", të këtij ligji."*

<sup>7</sup> Shih nenin 47 pika 1 "Kundërshtimi i udhëzimeve të përgjithshme" të ligjit nr.97, të vitit 2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", që parashikon: "1. Prokurori mund të kundërshtojë paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e udhëzimeve të përgjithshme, duke bërë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë."

<sup>8</sup> Shih nenin 132 "Afat i ankimit administrativ ndaj aktit administrativ" të ligjit nr.44, të vitit 2015 "Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", që parashikon: "1. Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen e aktit administrativ."

<sup>9</sup> Shih nenin 47 pika 2 "Kundërshtimi i udhëzimeve të përgjithshme" të ligjit nr.97, të vitit 2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", që parashikon: "2. Prokurori është i detyruar të ndjekë udhëzimet e ankimuara, me përjashtim të rastit kur vlerëson se ato janë haptazi në kundërshtim me ligjin."

<sup>10</sup> Shih nenin 42 shkronja "dh" "Kompetencat e drejtuesit në drejtimin e prokurorisë" të ligjit nr.97, të vitit 2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", që parashikon: "Drejtuesi i prokurorisë ushtron këto detyra: dh) mbikëqyr disiplinën në punë të prokurorëve dhe i bën kërkesë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të prokurorëve."

<sup>11</sup> Shih nenin 3 pika 3 "Vlerat themelore" të ligjit nr.96, të vitit 2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", që parashikon: "3. Magjistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Magjistrati njofton menjëherë Këshillin dhe kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij."



çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi dhe ushtron funksionet në zbatim të kushtetutës dhe ligjit.

## Neni 6

### **Qëndrueshmëria e organit të prokurorisë në raport me pavarësinë funksionale të prokurorit**

1. Pavarësia funksionale e prokurorit në vendimmarrje për çështje konkrete, duhet të garantohet, duke ruajtur njëkohësisht qëndrueshmërinë e organit të prokurorisë dhe uniformitetin e veprimtarisë së tij, përmes nxjerrjes dhe zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme nga Prokurori i Përgjithshëm dhe/ose Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, i cili kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore/kushtetuese në veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe kanë përgjegjësi ligjore për mbarëvajtjen e punës në prokurori, si dhe nxjerrin udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete për prokurorët e prokurorive që drejtojnë.

2. Rregullat që disjplinojnë autoritetin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër si prokuror më i lartë, në respekt të parimeve të ligjshmërisë dhe pavarësisë në ushtrimin e funksioneve të prokurorit, janë:

a) Respektimi i procedurës ligjore nga prokurori më i lartë për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme me shkrim dhe të arsyetuar:

i) për të siguruar zbatimin e njëjtë të ligjit material penal e ligjit procedural penal në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës/çështjes në gjykim, ushtrimin e të drejtës së ankimit/rekursit nga prokurori dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale, bazuar në vendime gjyqësore njësuëse ose unifikuese të Kolegjit Penal dhe Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>12</sup>.

ii) për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë për luftën kundër kriminalitetit, që përcaktojnë përparësitë për zbatimin e politikës penale dhe/ose mënyrat e ndjekjes së tyre.

iii) për përcaktimin e një tërësi kriteresh në zbatim të ligjit dhe unifikuar vendimmarrjen për çështje apo grup çështjesh ligjore të njëjta, që trajtohen ose kualifikohen ndryshe nga prokurorët në të njëjtën prokurori ose në prokurori të ndryshme me juridiksion të përgjithshëm.

b) Respektimi i procedurës ligjore nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete për prokurorët në prokuroritë përkatëse, të cilët duhet që:

<sup>12</sup> Shih nenin 438 “Ndryshimi i praktikës gjyqësore” të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon:

“1. Gjykata e Lartë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur lind nevoja për ndryshimin e praktikës gjyqësore, ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të ardhura për gjykim në Kolegjin Penal.

2. Tërheqja e çështjes në kolegje të bashkuara bëhet me vendim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjit Penal.

3. Kolegjet e bashkuara gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

4. Vendimi i Kolegjit Penal dhe kolegjeve të bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.”.



i) të jenë me shkrim dhe të arsyetuara dhe kur rrethanat nuk e lejojnë, të jepen verbalisht dhe brenda një kohe të arsyeshme, të konfirmohen me shkrim.

ii) në rastet kur prokurori ka kërkuar shpjegime për udhëzimin jo të detyrueshëm, pasi nuk është dakord apo ka paqartësi në lidhje me të, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër të japë shpjegime mbi udhëzimet jo të detyrueshme dhe t'i përsërisë ato në të njëjtën mënyrë, ndryshe udhëzimi konsiderohet i tërhequr.

c) Respektimi i të drejtës që prokurori ka sipas ligjit për heqjen dorë nga çështja konkrete që ka në ndjekje dhe kryerja e procedurës për zëvendësimin e tij<sup>13</sup>.

### KREU III MARRËDHËNIET NDËRMJET PROKURORIT DHE DREJTUESIT NË PROKURORI

#### Neni 7

#### **Të drejtat dhe detyrimet e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve në prokurori**

1. Të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në marrëdhëniet administrative me Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë:

a) Prokurori merr pjesë në çdo mbledhje të thirrur nga prokurori më i lartë<sup>14</sup> përveç rasteve të justifikuara sipas ligjit apo me akte normative përkatëse.

---

<sup>13</sup> Shih nenin 26 në lidhje me nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon:

*“1. Prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie për rastet e parashikuara nga neni 17.*

*2. Mbi deklarimin e heqjes dorë vendosin, sipas detyrave përkatëse, drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, i prokurorisë pranë gjykatës së apelit dhe Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Për drejtuesit e prokurorive vendosin titullarët e prokurorive të një shkalle më lart.*

*3. Me vendimin që pranon deklarimin e heqjes dorë, prokurori që ka hequr dorë zëvendësohet me një prokuror tjetër.”, nenin 27 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon:*

*“1. Drejtuesi i prokurorisë vendos zëvendësimin e prokurorit kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17 paragrafi i parë shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”. Në rastet e tjera prokurori zëvendësohet vetëm me pëlqimin e tij.*

*2. Shfuqizuar.*

*3. Rregullat e caktuara për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit zbatohen edhe për oficerin e policisë gjyqësore.” dhe nenin 49 “Zëvendësimi i prokurorit” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon:*

*“1. Prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji procedural penal.*

*2. Prokurori mund të zëvendësohet edhe kur, për shkak të mungesës ose paafësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore.*

*3. Drejtuesi i prokurorisë merr vendim me shkrim lidhur me zëvendësimin e prokurorit. Vendimi për tërheqjen e çështjes i dorëzohet prokurorit përkatës. Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, prokurori ka të drejtën të paraqesë ankim me shkrim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë kundër vendimit të zëvendësimit, brenda 5 ditëve nga marrja njoftim e tij. Vendimi me shkrim dhe ankimi përkatës janë pjesë e dosjes.*

*4. Vendimi lidhur me ankimin duhet të merret brenda pesë ditëve nga marrja e tij.*

*5. Ankimi nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit. Nëse ankimi pranohet, çështja i caktohet sërish prokurorit të cilit i ishte tërhequr.*

*6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen rregullisht, të paktën çdo vit, një inspektim tematik mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve.”.*

<sup>14</sup> Shih nenin 2 shkronja “c” “Përkufizime” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon:

*“c) Prokuror më i lartë është:*



b) Prokurori zbaton kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas ligjit dhe/ose me udhëzim të përgjithshëm në pjesëmarrjen në short apo në marrjen e një dosje/çështje që i është caktuar.

c) Prokurori merr pjesë në çdo diskutim të natyrës profesionale të thirrur nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe është pjesë konstruktive e këtyre diskutimeve.

ç) Prokurori duhet të respektojë orarin zyrtar dhe të gjitha detyrimet administrative të parashikuara në ligj dhe me aktet normative detyruese përkatëse.

d) Prokurori informon Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për çdo veprimtari jashtë funksionit të miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë sipas ligjit.

dh) Prokurori ndihmon organet administrative të prokurorisë kur i kërkohet brenda kompetencave dhe funksionit të tij.

2. Të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në marrëdhëniet procedurale me Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë:

a) Prokurori udhëhiqet nga pavarësia e tij procedurale në kryerjen apo kontrollin e hetimeve, ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit, ushtrimin e të drejtës së ankimit, urdhërimin dhe/ose mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale apo kryerjen e detyrave të tjera të caktuara me ligj<sup>15</sup>.

b) Prokurori në ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur ka detyrimin të respektojë Kushtetutën, kuadrin ligjor të veprimtarisë, udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe/ose të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ku ai është emëruar/ushton funksionet<sup>16</sup>.

*i) Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme dhe për prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe shkallës së parë, sipas përcaktimeve të këtij ligji;*

*ii) drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së apelit për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë kësaj prokurorie;*  
*iii) drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë kësaj prokurorie.”*

<sup>15</sup> Shih nenin 148 pika 1 të Kushtetutës, që parashikon: “1. Prokuroria ushton ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.” dhe nenin 24 “Funksionet e prokurorit” e vijues të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon:

“1. Prokurori ushton ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushton funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

2. Prokurori ka të drejtë të mos fillojë procedimin, të pushojë akuzën ose çështjen, t’i kërkojë gjykatës pushimin e akuzës ose çështjes, si dhe të kërkojë dërgimin e çështjes në gjyq, sipas rasteve të parashikuara nga ky Kod.

3. Prokurori ka të drejtë të lidhë marrëveshje bashkëpunimi, të hartuara në zbatim të nenit 37/a, të këtij Kodi, dhe të dispozitave ligjore të veçanta për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

4. Prokurori mund të arrijë një marrëveshje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, në përputhje me nenin 406/d e vijues të këtij Kodi.

5. Prokurori mund të paraqesë në gjykatë kërkesë për miratimin e urdhrit penal sipas parashikimeve të këtij Kodi.

6. Kur nuk është i nevojshëm ankimi i viktimës, ndjekja penale ushtrohet kryesisht.”

<sup>16</sup> Shih nenin 46, pikat 1, 2 dhe 4 “Udhëzimet e përgjithshme të detyrueshme” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon:

“1. Prokurorët më të lartë mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme dhe të arsyetuara me shkrim, të cilat janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme i nënshtrohen vetëm udhëzimeve të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

2. Udhëzimet e përgjithshme, sipas këtij neni, mund të jenë të natyrës administrative ose procedurale.

4. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që drejtojnë, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas



c) Prokurori ka detyrimin të informojë Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me ecurinë e procedimeve/çështjeve të caktuara.

ç) Prokurori duhet të shmangë çfarëdo lloj ndikimi dhe sjellje të paligjshme e të papërshtatshme që cënon drejtësinë dhe imazhin e prokurorisë<sup>17</sup>.

d) Çdo marrëdhënie që lidhet me çështjen apo funksionet e tij si prokuror duhet të ushtrohet prej tij në rrugë institucionale.

dh) Prokurori njofton Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër në rastet që konstaton se ka papajtueshmëri apo konflikt interesi të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë me çështjen konkrete që ka në ndjekje apo në shqyrtim gjyqësor<sup>18</sup>.

e) Prokurori duhet të marrë pjesë në grupet e përbashkëta hetimore ose në procedime të lidhura në zbatim të ligjit dhe/ose planifikimit të bërë nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër<sup>19</sup>.

## Neni 8

### **Kompetencat dhe roli i drejtuesit në prokurori në marrëdhënie me prokurorët**

1. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është përgjegjës për krijimin e kushteve që bëjnë të mundur organizimin e punës, respektimin e ligjit, etikës dhe mirëfunksionimin e prokurorisë<sup>20</sup> dhe për mbarëvajtjen e punës dhe sigurimin e efikasitetit, efencës, ligjshmërisë dhe transparencës në veprimtarinë e prokurorisë<sup>21</sup> që drejton, sipas parashikimeve të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

---

*nenit 43, shkronja “dh”, të këtij ligji. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk mund të nxjerrë udhëzime që haptazi vijjnë në kundërshtim me udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm.”.*

<sup>17</sup> Shih nenin 3 “Vlerat themelore” të ligjit nr.96, të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>18</sup> Shih nenin 51 “Shmangia e konfliktit të interesit” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, prokurorët detyrohen të shmangin çdo konflikt interesi, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.” në lidhje me nenin 3 pikat 1 e 4 dhe nenet 4, 5 e vijues të ligjit nr.9367, të vitit 2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve”.

<sup>19</sup> Shih nenin 42 shkronja “ç” “Kompetencat e drejtuesit në drejtimin e prokurorisë” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “Drejtuesi i prokurorisë ushtron këto detyra: ç) krijon grupe hetimore për çështje të veçanta.” në lidhje me nenin 306 të Kodit të Procedurës Penale.

<sup>20</sup> Shih nenin 42 shkronja “a” “Kompetencat e drejtuesit në drejtimin e prokurorisë” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “Drejtuesi i prokurorisë ushtron këto detyra: a) organizon punën dhe merr masat e nevojshme për mirëfunksionimin e prokurorisë.”.

<sup>21</sup> Shih nenin 52 “Drejtimi administrativ i prokurorisë” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon:

*“1. Drejtuesi i prokurorisë është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë që drejton.*

*2. Prokurorët kanë detyrimin të informojnë drejtuesin e prokurorisë, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me punën mbi çështje të caktuara dhe vendimmarrjen, si dhe, në raste të veçanta, për problematika që shfaqen në ecurinë e procedimit.*

*3. Drejtuesi i prokurorisë merr masa për të garantuar përmbushjen e funksioneve administrative të prokurorisë, përfshirë mbajtjen e regjistrave e raporteve, mbajtjen e protokollit e arkivit, administrimin financiar e material,*



## Neni 9

### **Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre**

1. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër garanton dhe lehtëson zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm<sup>22</sup>, duke nxjerrë dhe udhëzime të përgjithshme, si dhe struktura përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme mbikëqyr zbatimin e tyre.

## Neni 10

### **Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre**

1. Udhëzime jo të detyrueshme për kryerjen e veprimeve procedurale përpara se të merret vendimi për mënyrën e përfundimit të procedimit/çështjes konkrete<sup>23</sup> mund të jepen/nxirren nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

2. Udhëzimet mund të nxirren nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në momentin e caktimit, të kallëzimit penal apo referimit të veprës penale dhe/ose të procedimit/çështjes për ndjekje prokurorit, ose gjatë procesit të verifikimit të ecurisë së procedimit/çështjes, kur Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër e vlerëson të nevojshëm për mbarëvajtjen apo mënyrën e përfundimit të procedimit/çështjes<sup>24</sup>.

---

*menaxhimin informatik, ndarjen e brendshme e detyrave, shqyrtimin e ankesave dhe detyra të tjera që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë.”.*

<sup>22</sup> Shih nenin 42 shkronja “g” “Kompetencat e drejtuesit në drejtimin e prokurorisë” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “Drejtuesi i prokurorisë ushtron këto detyra: g) garanton zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.” dhe nenin 43 shkronja “dh” “Kompetencat në ushtrimin e ndjekjes penale” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “Drejtuesi i prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale: dh) garanton zbatimin korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.”.

<sup>23</sup> Shih nenin 43 shkronja “ç” “Kompetencat në ushtrimin e ndjekjes penale” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “Drejtuesi i prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale: ç) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48 të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.” dhe nenin 48 pika 1 shkronja “c” “Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “Udhëzime për çështje konkrete mund të jepen nga: c) drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit për prokurorët e prokurorisë përkatëse.”.

<sup>24</sup> Shih nenin 48 pika 3 “Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “3. Udhëzimet në lidhje me procedime konkrete, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, mund të jepen kryesisht në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje të prokurorit, ose më pas, kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit.” dhe nenin 43 shkronja “ç” “Kompetencat në ushtrimin e ndjekjes penale” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “Drejtuesi i



a) Udhëzimet duhet të jepen me shkrim dhe të arsyetuara.

b) Përjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht dhe brenda 48 orëve të konfirmohen me shkrim.

3. Në rastet, kur prokurori i udhëzuar nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me udhëzimet e dhëna, brenda 5 (pesë) ditëve ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtjshme për udhëzimet ose për pjesë të tyre.

a) Në këto raste, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, brenda 5 (pesë) ditëve, është i detyruar të japë shpjegime mbi udhëzimet dhe t'i përsërisë ato në të njëjtën mënyrë, përndryshe udhëzimi konsiderohet i tërhequr<sup>25</sup>.

4. Në rastet kur prokurori, ndaj të cilit është përsëritur udhëzimi me shkrim, vendosë të mos e zbatojë udhëzimin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ai duhet të njoftojë brenda 5 (pesë) ditëve me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, duke arsyetuar shkaqet e moszbatimit të udhëzimit prej tij.

5. Udhëzimi me shkrim dhe përgjigjet e prokurorit i bashkëlidhen akteve të procedimit penal.

## KREU IV MËNYRA E INFORMIMIT TË DREJTUESVE NË PROKURORI

### Neni 11

#### Informimi i drejtuesit të prokurorisë nga prokurori

1. Zyra e regjistrimit në prokurori njofton Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për çdo vendim për regjistrimin e procedimit penal të marrë nga prokurorët.

2. Prokurori informon Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas kërkesës së tij, mbi ecurinë dhe problemet e veprimeve të para hetimore në rastet e ngjarjeve të ndodhura përgjatë kryerjes së gatishmërisë dhe/ose mbi ecurinë e procedimi penal, përpara përfundimit të tij.

3. Në rastet kur gjykata i kthen aktet prokurorit, prokurori, mbi kërkesën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, duhet të informojë Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për shkaqet dhe ecurinë e mëtjshme të hetimit brenda 5 (pesë) ditëve nga kërkesa.

---

*prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale: ç) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48 të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtjshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.”.*

<sup>25</sup> Shih nenin 48 pika 5 “Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete” të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon: “5. Kur prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me udhëzimet e dhëna, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtjshme lidhur me to. Drejtuesi i prokurorisë ose drejtuesi i seksionit është i detyruar të japë shpjegime dhe t'i përsërisë ato në të njëjtën mënyrë, përndryshe udhëzimi konsiderohet i tërhequr. Në rast se prokurori, ndaj të cilit është përsëritur udhëzimi, me shkrim, vendos të mos e ndjekë atë, njofton me shkrim drejtuesin e prokurorisë apo drejtuesin e seksionit, sipas rastit.”.



4. Zëvendësdrejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, që është i gatshëm sipas grafikut të gatishmërisë, duhet të njoftojë Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për çdo kërkesë drejtuar gjykatës lidhur me arrestimet në flagrancë, ndalimet, masat e sigurimit personal dhe/ose pasuror, mjetet për kërkimin e provës, sigurimin e provës, për aktet drejtuar insitucioneve të vuajtjes së denimit me burgim, masat mjekësore apo shërbimeve policore, të cilat nënshkruhen nga zëvendësdrejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në mungesë të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

## Neni 12

### **Informimi mbi masat e sigurimit personal dhe pasuror**

1. Prokurorët, me qëllim që të mundësojnë drejtuesin për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, në përputhje me parashikimet e nenit 48 të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, përveç rasteve kur urgjenca nuk e lejon, duhet të informojnë paraprakisht Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas organizimit të brendshëm në prokurori, për procedimin penal ku do të nxirren urdhra ndalimi ose do t'i drejtohen gjykatës kërkesa për caktimin e masave të sigurimit arrest në burg, arrest në shtëpi, kërkesa për aplikimin e sekuestrove preventive, konservative apo për hetimin pasuror ku do të kërkohet aplikimi i masave ndaj pasurisë në kuadër të ligjit nr.10192, të vitit 2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese për hetimin e pasurisë”, të ndryshuar.

2. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër mund të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme brenda 1 (një) dite nga marrja e informacionit.

3. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për procedime penale ku janë vendosur masat e sigurimit të parashikuara nga nenet 237 dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale, apo janë aplikuar sekuestroja preventive, konservative, apo për hetime pasurore ku janë aplikuar masa ndaj pasurisë në kuadër të ligjit nr.10192, të vitit 2009, me qëllim nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, mundet që t'i kërkojë prokurorit në momentin e regjistrimit të procedimit penal, hetimit pasuror apo përgjatë hetimit penal apo pasuror, të informohet paraprakisht, por jo më vonë se 1 (një) muaj përpara përfundimit të afateve të paraburgimit, të sekuestros, apo masave ndaj pasurisë në kuadër të ligjit nr.10192, të vitit 2019, për gjendjen e procedimit penal apo hetimit pasuror. Informacioni bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë:

a) Veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, gjendjen e procedimit penal apo hetimit e gjykimit pasuror, pyetjen e të pandehurit ose të personit nën hetim dhe personave të tjerë, si dhe përshkrimin e të dhënave të marra.

4. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër mund të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e informacionit.



### Informimi për ecurinë e ushtrimit të ndjekjes penale dhe hetimit pasuror

1. Prokurorët informojnë Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, mbi kërkesën e këtij të fundit, për ecurinë e procedimit penal apo hetimit pasuror jo më vonë se 20 ditë përpara se të vendosin përfundimin e hetimeve, shpalljen e moskompetencës lëndore apo tokësore në një procedim penal apo të kërkojnë konfiskimin ose vendosin pushimin e hetimit pasuror, në të cilin Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme ose u është kërkuar sa më sipër nga ky i fundit në momentin e regjistrimit të procedimit penal apo hetimit pasuror për shkak të rëndësisë së tij.

2. Informacioni bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, të dhëna për personat nën hetim dhe veprat penale që hetohen, masat ndaj pasurisë dhe çështje të tjera me rëndësi.

3. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër mund të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme jo më vonë se 3 (tre) ditë nga marrja e informacionit.

### Informimi për përfaqësimin e akuzës në gjyq

1. Në rastet kur gjykata nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit lidhur me deklarin e fajësisë, cilësimin juridik të veprës, llojin e dënimit dhe konfiskimin në bazë të nenit 36 të Kodit Penal ose ligjit nr.10192, të vitit 2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese për hetimin e pasurisë”, të ndryshuar, prokurori informon Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër brenda 3 (tre) ditëve nga kërkesa e këtij të fundit, për vendimin dhe nëse do të ushtrojë apelim.

2. Prokurori që ka ushtruar apelim kundër vendimit të gjykatës<sup>26</sup>, në rastet kur pas shqyrtimit gjyqësor janë zbuluar prova ose rrethanat e reja që i shërbejnë rigjyqimit të çështjes së ankimuar, duhet të njoftojë Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe sipas rastit përgatit shtesë ankimin, si dhe njofton prokurorin dhe/ose drejtuesin e prokurorisë pranë gjykatës që shqyrton ankimin.

<sup>26</sup> Koment:

“Arsyet dhe shkaqet e shtesës së apelimit kundër vendimit gjyqësor mund të jenë, si në gjykimin e themelit rastet kur i pandehuri për mungesë provash: -është deklaruar i pafajshëm (p.sh. për mungesë të një prove të kërkuar autoriteteve gjyqësore të huaja apo të provave të reja që kanë dal pas shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë, etj.) ose i është ndryshuar cilësimi juridik i veprës penale (p.sh. për mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë që provon se bashkëpandehuri në një procedim të lidhur është deklaruar fajtor dhe dënuar për kryerjen e të njëjtës vepër penale në rrethana të cilësuar, etj.) apo -i është caktuar një lloj a masë dënimi më e butë (p.sh.për mungesë të dëshmisë së penaltetit që provon se është dënuar pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë, rrethanë rënduese sipas nenit 50 shkronja “ç” të Kodit Penal, etj.), ashtu dhe në gjykimin e masave të sigurimit në rastet kur ka progres në rritje ose në ulje të kushteve dhe kritereve ligjore lidhur me masat e sigurimit të ankimuar, sipas përcaktimeve në nenin 246 pika 6 dhe vendimin unifikues nr.1, të vitit 2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.”.



## Neni 15

### **Delegimi i kompetencave dhe informimi i zëvendës drejtuesit në prokurori**

1. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër njofton paraprakisht Prokurorin e Përgjithshëm për periudhën kohore të delegimit të kompetencave të tij zëvendës drejtuesit, duke vënë në dijeni dhe prokurorët në atë Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

2. Në mungesë të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, prokurori është i detyruar t'i përgjigjet kërkesave të zëvendës drejtuesit të parashikuara në nenet 11, 12, 13 dhe 14 të këtij udhëzimi të përgjithshëm.

## Neni 16

### **Qarkullimi i shkresave, akteve dhe materialeve hetimore**

1. Për të garantuar transparencën e marrëdhënieve dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga ligji nr.97, i vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të tij, qarkullimi i shkresave, akteve dhe materialeve hetimore mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve në prokurori të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, do të kryhet përmes protokollimit në regjistrin e komunikimeve të brendshme, sipas modelit lidhja nr.1 bashkëlidhur udhëzimit nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar me udhëzimin nr.16, datë 14.12.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për disa ndryshime në udhëzimin e përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm””, në zbatim të këtij udhëzimi.

2. Në regjistër do të pasqyrohen të gjitha komunikimet e brendshme mes Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe prokurorëve, që lidhen me sa vijon:

a) kërkesën për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër apo personi i deleguar në rastet e parashikuara nga ky udhëzim

b) dhënien e informacionit nga prokurori në rastet e parashikuara nga ky udhëzim,

c) nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, përsëritjen e tyre me shpjegimet, nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër,

d) kërkesën e prokurorit për shpjegime të mëtejshme nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër,

dh) refuzimin e ndjekjes së udhëzimeve të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nga prokurori,

e) kalimin për firmë tek Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër të shkresave dhe akteve apo materialeve bashkëlidhur që i drejtohen gjykatës, për kërkesat që lidhen me masat e sigurimit, përgjimet, sekuestron



preventive, konservative, sekuestron dhe konfiskimin në bazë të ligjit nr.10192, të vitit 2009, pushimin e procedimit penal, dërgimin për gjykim, vënien në ekzekutim të vendimeve penale,

ë) kalimin për firmë tek Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër të shkresave apo akteve dhe materialeve bashkëlidhur që lidhen me pezullimin e procedimit penal, shpalljen e moskompetencës lëndore ose tokësore, njoftimet e palëve dhe viktimitës për mosfillimin e procedimit penal,

f) kalimin tek prokurori të shkresave të firmosura nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, të parashikuara në gërmat “e” dhe “ë” të nenit 17 të këtij udhëzimi.

3. Prokurori ka detyrimin që çdo shkresë që do ia përcjellë për firmë Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër si dhe aktet apo materialin hetimor bashkëlidhur, ta dorëzojë kundrejt firmës tek nëpunësi që mban regjistrin e komunikimeve të brendshme.

4. Nëpunësi i regjistrin, pasi protokollon në regjistër shkresën dhe materialin bashkëlidhur, ja kalon menjëherë Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër kundrejt firmës.

5. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër duhet të firmosë çdo shkresë përcjellëse që lidhet me materialet kallëzuese, procedimet penale, verifikimet pasurore dhe procedimet pasurore jo më vonë se 48 orë nga protokollimi i saj në regjistrin e komunikimeve të brendshme dhe ja dorëzon nëpunësit të regjistrin kundrejt firmës.

6. Çdo akt apo material hetimor që i bashkëlidhet shkresës protokollohet së bashku me shkresën dhe qarkullon i pashkëputur nga ajo.

7. Nëpunësi i regjistrin pasi protokollon në regjistër dorëzimin nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër të shkresës dhe akteve apo materialeve bashkëlidhur, ia kalon ato menjëherë kundrejt firmës prokurorit.

8. Nëpunësi i regjistrin të komunikimeve të brendshme në prokurori mban përgjegjësi për rregullshmërinë mbajtjes së këtij regjistri.

9. Të paktën 1 (një) herë në vit, rregullshmëria e mbajtjes së këtij regjistri kontrollohet nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme.

## KREU V

### PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

#### Neni 17

#### Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

1. Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, kur nuk përbëjnë vepër penale, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit<sup>27</sup> dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori

<sup>27</sup> Shih nenin 148/d paragrafi 1 i Kushtetutës dhe nenet 101 pika 1 shkronja “a” dhe “b” dhe 102 pika 1 shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “g”, “i”, “j” dhe “nj”; pika 2 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit nr.96, të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.48, të vitit 2019.



i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit dhe/ose Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas ligjit.

Neni 18  
**Zbatimi**

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Neni 19  
**Njohja**

Me këtë udhëzim të përgjithshëm të njihen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Neni 20  
**Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe depozitimit në sekretari.

